



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 22.12.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 17.12.2021 (pranuar me datë 19.12) të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Team 8" për aktivitetin: "Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artistik të tunelit të Kurrizit" dhe me numër të prokurimit: **616-21-7371-223** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "ADL Studio SHPK" e datës 20.12.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artistik të tunelit të Kurrizit" dhe me numër të prokurimit: **616-21-7371-223**.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Team 8" me datë 18.12.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artistik të tunelit të Kurrizit" dhe me numër të prokurimit: **616-21-7371-223**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.12.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi i juaj është i pabazuar, pasi që konkursi i projektimit sipas dispozitave ligjore duhet të jetë anonim në fazën e parë, që d.t.th.se koncepti i projektit duhet të dorëzohet me shifra me qëllimin që të mos identifikohen kandidatët dhe të bëhet vlerësimi objektiv i koncepteve të dorëzuara.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv. Aktiviteti do të kthet në rivlerësim në bazë të kërkesës të një kandidati tjetër, ndërsa tenderi juaj nuk do të jetë i pranueshëm as në këtë fazë për arsyet e paraqitura më lartë.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

